

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

(Të gjitha balancat janë në lekë).

Informacione te pergjithshme

Shoqeria "ZENITH TRAVEL" shpk eshte krijuar ne Q.K.B dt. 12/10/2011.

Forma ligjore e shoqerise eshte Sh.P.K.

Vlera e kapitalit te shoqerise eshte 800 000 leke e ndare ne 800 aksione me vlere nominale 1000 leke aksioni.

Shoqeria "ZENITH TRAVEL" shpk ka nje aksioner te vetem qe zoteron 100 % te kontributit ne kapital.

Pjesemarrja ne kapital eshte:

-Bledar Sula 100 % te kapitalit.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise eshte:

Transport udhetaresh brenda dhe jashte vendit per vete dhe te trete.Agjenci turistike.Agjenci udhetimesh.Import-eksport, tregti te artikujve te ndryshem. Operator turistik.

Selia e shoqerise eshte Rruga e Durrësit, Pallati 220, Shkalla 3, Kati 1, Apartamenti 17, Tirane.

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë").

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare eshte zbatuar formati i SKK-2 i permiresuar.

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur , janë si më poshtë:

– Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve.Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogaritet me besueshmëri.Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose

rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

– **Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit, i përdorur për monedhen e huaj më kryesore, më 31.12.2023 është 1 euro=103.88 leke.

– **Tatimin mbi fitimin**

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2023 është 15 % dhe nuk ka ndryshime me periudhën paraardhëse.

– **Kërkesat për t'u arkëtuar**

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

– **Pasivet financiare**

Huate e mara, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale, kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

– **Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara**

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si

rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazen e metodes lineare për ndertesat dhe mbi bazen e vleres së mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Normat e përdorura janë në ndertesa 5 % të vlerës fillestare dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur.

– Gjendjet e inventareve

Vlerësimi në hyrje të inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventaret në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto të realizueshme.

Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjeteve monetare në banke dhe arke, në leke dhe valute, në datat 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2023 janë si më poshtë:

Emertimi	Viti raportues 31.12.2023	Viti paraardhës 31.12.2022
Aktive monetare	2,617,938	16,174,653

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të Bankës së Shqipërisë.

INVESTIME

Shoqëria nuk ka investime në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit, në aksionet e veta dhe të tjera financiare.

TE DREJTA TE ARKETUESHME

Kerkesat e arketueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2023 deklarohen si vijon:

Emertimi	Viti raportues 31.12.2023	Viti paraardhës 31.12.2022
Të drejta të arkëtueshme	44,468,543	41,693,868
1 <i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	33,607,876	33,124,248
2 <i>Nga njësitë ekonomike brenda grupit</i>	0	0

Emertimi		Viti raportues 31.12.2023	Viti paraardhës 31.12.2022
3	<i>Nga njësiti ekonomike ku ka interesa pjesë</i>	0	0
4	<i>Të tjera</i>	10,860,667	8,569,620
5	<i>Kapital i nënshkruar i papaguar</i>	0	0

Ne –Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit jane pasqyruar kerkesat ndaj klienteve. Listat analitike te tyre me vlerat përkatëse jepen ne anekset e pasqyrave financiare.

Ne- Te tjera te arketueshme eshte pasqyruar teprica kreditore e tvsh-s prej 10,650,177 leke si pasoje e investimeve ne aktive te qëndrueshme, teprica prej 11217 leke teprice kreditore ne dogane, pagesa prej 19,750 per llogari te shoqërisë Zenith Travel & Tours shpk, detyrim ne vlerën 14,371 qeradhenesit si dhe teprica e Tatimit mbi fitimin ne vlerën 165,152 leke e cila do te kthehet ne afatshkurtër.

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat qe lidhen me klientet do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

Inventari

Shoqeria nuk ka gjendje inventari lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme ne fund te periudhes kontabel.

Shpenzime te shtyra

Per periudhën 2023, shoqëria nuk ka shpenzime te shtyra.

Te Arketushme nga te ardhura te konstatuara.

Shoqeria nuk ka te arketushme nga te ardhura te konstatuara.

Aktivitet Afatgjata

Aktive financiare afatgjata

Shoqeria nuk ka aktive afatgjata financiare.

Aktivitet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet :

EMERTIMI		Viti raportues 31.12.2023	Viti paraardhës 31.12.2022
Aktivitet materiale		72,796,969	29,755,026
1	<i>Toka dhe ndërtesa</i>	37,749,075	
2	<i>Impiante dhe makineri</i>	34,387,083	29,322,322
3	<i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	660,811	432,704
4	<i>Parapagime për aktive materiale dhe në proces</i>	0	0

Ne postin *Toka dhe ndërtesa* është pasqyruar vlera e truallit dhe ndërteses që shoqëria ka blerë gjatë vitit ushtrimor në funksion të aktivitetit.

Ne postin e *impiante dhe makineri* është pasqyruar vlera e mbetur e mjeteve të transportit në pronesi të shoqërisë.

Të tjera Instalime dhe pajisje janë pasqyruar vlera e mbetur e pajisjeve të zyrave dhe atyre elektronike.

Vlersimi I tyre është bërë me vlerën neto kontabel, dhe grupimi I tyre është bërë sipas standartit përkatës të kontabilitetit.

Amortizimi për vitin ushtrimor është llogaritur.

Norma e amortizimit e aplikuar është e barabartë me normën e lejuar.

Aktive biologjike afat gjatë

Shoqëria nuk ka aktive biologjike afatgjatë.

Aktive Afat gjatë jo materiale

Shoqëria nuk ka aktive afatgjatë materiale.

Detyrimet që shoqëria ka, janë pasqyruar si më poshtë:

EMERTIMI		Viti Raportues 31.12.2023	Viti Paraardhës 31.12.2022
Detyrime afatshkurtra:		9,360,351	9,360,351
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>	676,864	676,864
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>		
3	<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>		
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	6,359,954	3,753,729
5	<i>Dëftesa të pagueshme</i>		
6	<i>Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit</i>		
7	<i>Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pje</i>	0	
8	<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	6,918,201	4,923,758
9	<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	6,000	6,000

Ne postin- *Titujt e huamarrjes*, perfshihet shuma 643,240 leke e kaluar gabimisht ne nr e llogarise te shoqerise Zenith Travel shpk nga nje individ, arketime te shoqerive ALBREEZE SHPK dhe PRODATA SECURITIES SHA, te cilat jane shlyerje te sherbimeve te kryera nga shoqeria Zenith Travel & Tours shpk, edhe keto kaluar gabimisht ne llogarin e shoqerise Zenith Travel shpk. Si dhe detyrimi ndaj FINAXIT SRL, ne vlere 11,166 leke.

Te pagushme per aktivitetin e shfrytezimit jane pasqyruar detyrimet ndaj furnitorve qe lidhen me blerjet e realizuara gjate vitit ushtrimor. Lista e detajuar me shumet perkatese ndaj furnitoreve jepet ne anekset e Pasqyrave Financiare.

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore jane detyrimet qe lidhen me pagat e papagura te punonjesve te shoqerise dhe sigurimet shoqerore, shendetesore dhe tap te papaguar te muajit te fundit te vitit 2023.

Të pagueshme për detyrimet tatimore pasqyrojne detyrimin per tatimin ne burim per muajin dhjetor 2023.

Drejtimi mendon se te gjitha detyrimet afat shkurtra do te paguhen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

Detyrimet ne monedhe te huaj jane vlersuar me kursin e bankes se Shqiperise te dates 31.12.2023.

Te pagueshme per shpenzime te konstatuara

Shoqeria nuk ka te pagueshme per shpenzime te konstatuara.

Te ardhura te shtyra

Emertimi	Viti raportues 31.12.2023	Viti paraardhës 31.12.2022
Te ardhura të shtyra	40,300,000	51,800,000

Posti te ardhura te shtyra paraqet faturimet e parapagimeve qe ju jane dhene klienteve gjate periudhave te kaluara, realizimi i sherbimeve te te cilave ende nuk eshte kryer.

Provizione

Shoqeria nuk ka provizione.

Detyrimet afat gjata paraqiten si me poshte:

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Viti Raportues 31.12.2024	Viti Paraardhes 31.12.2023
	Detyrime afatgjata:	41,741,764	8,817,747
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>	28,482,189	8,817,747
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>		
3	<i>Arkëtimet në avancë për porosi</i>		
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		
5	<i>Dëftesa të pagueshme</i>		

6	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit		
7	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		
8	Të tjera të pagueshme	13,259,575	

Ne detyrimet afatgjata te shoqerise, posti- *Titujt e huamarrjes* pasqyrohet vlere e mbetur e kredise se marr gjate vitit ushtrimor prane Bankes se Bashkuar te Shqiperise. Kjo kredi eshte marr per te financuar pjeserisht blerjen e aktiveve afatgjata, truallin dhe ndertesën.

Ne postin *Të tjera të pagueshme* pasqyrohet huaja qe shoqëria ka marr te te tretet sipas kontratave te nenshkuara nga palet. Format e likuidimit jane parashikuar ne kontratat perkatese dhe jane pa interes.

Te ardhura te shtyra

Shoqeria nuk ka te ardhura te shtyra afatgjata.

Provizione

Shoqeria nuk ka provizione.

KAPITALET

Kapitalet e veta:

Kapitalet e veta te shoqerise jane si vijon:

		Viti Raportues 31.12.2023	Viti Paraardhes 31.12.2022
	EMERTIMI		
▶	Kapitali dhe Rezervat		
▶	Kapitali i Nënshkuar	800,000	800,000
▶	Primi i lidhur me kapitalin	0	0
▶	Rezerva rivlerësimi	0	0
▶	Rezerva të tjera	2,296	2,296
	1 Rezerva ligjore	2,296	2,296
	2 Rezerva statutore	0	0
	3 Rezerva të tjera	0	0
▶	Fitimi i pashpërndarë	16,843,153	9,271,403
▶	Fitim / Humbja e Vitit	6,235,218	7,571,750
	Totali i Kapitalit	23,880,667	17,645,449

Gjate ushtrimit kontabel 2023 eshte realizuar nje fitim prej 6,235,218 leke i cili i perket aktivitetit te transportit te udhetareve, agjencise turistike dhe fitimit nga shitja e aktiveve te qendrueshme.

Pasqyra e Performancës

(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës

Pershkrimi i Elementeve	2023	2022
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	116,232,302	90,924,356
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në process	-	0
Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar		0
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	4,248,000	0
Totali te ardhurave	120,480,302	90,924,356

TE ARDHURAT

Të ardhurat nga shitja janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja. Njohja dhe vlerësimi janë bazuar në SNK-9.

Paraqitja në pasqyrat financiare është bërë sipas natyrës së tyre.

Te ardhura gjithëpërshirëse

Shoqëria nuk ka të ardhura gjithëpërshirëse.

Shpenzimet e veprimtarisë kryesore.

Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2023	Viti Paraardhës 31.12.2022
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	(42,356,257)	(37,730,604)
Të tjera shpenzime	(42,411,528)	(22,787,261)
Pagat e personelit	(14,630,184)	(11,249,290)
Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shënd.	(2,443,059)	(1,878,630)
Amortizimet dhe zhvlerësimet	(8,057,694)	(5,784,814)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	0	0
Totali i shpenzimeve	(109,898,722)	(79,430,599)

Konsumi i materialeve, karburantit, mallrave, furniturave, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë regjistruar me shumën e paguar ose të pagueshme. Shërbimet e serviseve, telefonit, internetit, kancelarisë, mirëmbajtje dhe riparime, taksat lokale dhe shpenzimet e rezervimeve të hoteleve brenda dhe jashtë vendit, biletat, vlera kontabel e e AQ të shitura si dhe shpenzime të tjera që lidhen me aktivitetin e shoqërisë janë llogaritur dhe pasqyruar në llogaritë e ushtrimit, në zerin shpenzime të tjera.

Kostoja e punësimit, page dhe sigurime shoqërore, është pasqyruar saktësisht si shpenzim me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar.

Shpenzimet e amortizimit janë përlllogaritur me normat e lejuara respektivisht mbi vlerën mbetur të aktiveve të qendrueshme, të cilat kanë gjendje në fillim të vitit dhe shtesat e vitit ushtrimor.

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane pasqyruar si me poshte:

	Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2023	Viti Paraardhes 31.12.2022
	Shpenzime financiare	(3,243,976)	(2,583,944)
1	<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)</i>	(1,061,409)	(292,070)
2	<i>Shpenzime të tjera financiare</i>	(2,182,567)	(2,291,874)

Ne postin Shpenzime interesi dhe te ngjashme jane pasqyruar shpenzimet e interesit te kredise, te cilat jane paraqitur si difference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

Ne postin shpenzime te tjera jane pasqyruar efekti i rivleresimit nga kursi i kembimit dhe komisonet bankare.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin.

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2023 jane si vijon:

PERCAKTIMI I REZULTATIT TATIMOR	Viti 2023	Viti 2022
Fitimi/Humbja para tatimit	7,337,604	8,909,813
Shpenzime te pa njohura per efekt fiskal	11,637	10,605
Amortizimi tej normave fiskale	-	-
shpenzime sporizimi tej kufirit lejuar	-	-
Gjoha,penalite demshperblime	11,637	10,605
Provizione e shpenzime te tjera te pa njohura	-	-
Shpenzime pa ft.tatimore		
Te tjera(interesa bankare mbi 1:4)	-	-
Fitimi/Humbja para llogaritjes tatimit	7,349,241	8,920,418
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	1,102,386	1,338,063
Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë		
Fitimi/Humbja e vitit	6,235,218	7,571,750

Rezultati i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme. Per vitin 2022 shoqeria ka pasur shpenzime te panjohura ne vleren 10,605 leke, te cilat jane gjoha dhe penalitete.

Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundeshme, jane kryer ne perputhje me formen ligjore te tyre, ne 31 dhjetor 2023.

Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare. Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2023 kemi fitim te shoqerise ne vlere neto 6,235,218 leke.

Shifrat krahasuese

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2023 eshte zbatuar formati i SKK-2 i permiresuar.

Vijushmeria e aktivitetit

Vijushmeria e biznesit eshte e garantuar edhe per vitin ne vazhdim .

Argumentuar kjo me;

- Ka emer te mire per sherbimet cilesore qe afron.*
- Ka gjendje cash dhe kerkesa per te arketuar per te perballuar disa detyrime .*
- Per momentin nuk ka asnje konflikt gjyqesor me kreditorët.*
- Eshte korekte ne mardhenie me shtetin.*
- Ka realizuar nje norme te mire fitimi.*
- Ka kryer investime prej te cilave pret rritje te metejshme te te ardhurave.*

Kemi ndjekur dhe analizuar ngjarjet pas mbylljes se Bilancit dhe deri ne ditën e sotme, por ato nuk ndikojne ne bilancin e mbyllur me 31.12.2023.

Tirane me, 21 mars 2024.

Hartoi Shenimet e Pasqyrave Financiare

LIONIKA ALLMUÇA

Lionike Allmuça
